REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 05 / 08 / 2026
Nr.Orgv Org.jed. 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 84 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 02
Ferizaj - Uroševac

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.84
Date: 31.07.2026

Në bazë të dispozitave nenit 12 te Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 te dates 28.06.2013, nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/L-139 me ndryshime dhe plotësime të Ligjit numër 03/L-205 të datës 28.10.2010, dhe dispozitave te nenit 31 Ligji nr. 10/l-022 për banim social dhe të përballueshëm, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.07.2026 miratoi këtë:

Vendim
Për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të ngastrave kadastrale 678-1, 678-2 Z.K.Talinovc i Jerlive.

I

Shpalljen Interes i Përgjithshëm-Publik pjesët e ngastrave kadatsrale:

-678-1 Z.K. Talinovc I Jerlive, me sipërfaqe prej 2802 m², pronë P.SH.KOMBINATI BUJQËSOR INDUSTRIAL MILLAN ZEQAR FERIZAJ, dhe
-678-2 Z.K. Talinovc I Jerlive, me sipërfaqe prej 2963 m², pronë P.SH.KOMBINATI BUJQËSOR INDUSTRIAL MILLAN ZEQAR FERIZAJ.

II

Ngastra kadastrale Shpallet Interes i Përgjithshëm-Publik me qëllim:
Zhvillimin e banimit te perballueshem dhe social.

III

Autorizohet Kryetari I Komunës që të kërkoj nga Qeveria e Republikës së Kosovës fillimin e procedures së shpronësimit për njesine kadastrale të përshkruara më lart sepse të njejtat janë nën menaxhimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës-Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

V

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi I KK-së

Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 05 / 08 / 2026
Nr.Orgv Org.jed 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 86 | Nr. Faqeve. Br. Strana. 02
Ferizaj - Uroševac

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.86
Data: 31.07.2026

Në bazë të dispozitave nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 te dates 28.06.2013, nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139 me ndryshime dhe plotësime të Ligjit numër 03/L-205 të datës 28.10.2010, dhe dispozitave te nenit 31 Ligji nr. 10/l-022 për Banim Social dhe të Përballueshëm, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.07.2026 miratoi këtë:

Vendim
Për Shpalljen interes i përgjithshëm të ngastrës kadastrale 100-1 Z.K.Ferizaj.

I

Me anë të këti vendimi shpallen Interes i Përgjithshëm-Publik ngastra kadatsrale: **100-1** Z.K. Ferizaj, me sipërfaqe prej 4339 m², pronë e N.SH. PASURIA BUJQESORE.

II

Ngastra kadastrale Shpallet Interes i Përgjithshëm-Publik me qëllim: Zhvillimin e banimit social dhe të përballueshëm.

III

Autorizohet Kryetari I Komunës që të kërkoj nga Qeveria e Republikës së Kosovës fillimin e procedures së shpronësimit për njesine kadastrale të përshkruara më lart sepse të njejtat janë nën menaxhimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës-Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

V

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi I KK-së

Xhavit Zariqi

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.88
Data:31.07.2026

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të ligjit për vetëqeverisjen lokale, Nr.03/L-040, si dhe në bazë të UDHËZIM ADMINISTRATIV (MAPL) NR. 06/2018 PËR STANDARDET MINIMALE TË KONSULTIMIT PUBLIK NË KOMUNA1si dhe nenit 51 pika 2.9 të stautit të Komunës së Ferizajt, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.07.2026 miratoi këtë:

VENDIM
Për miratimin e plotësim ndryshimit të Strategjisë për zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë në Komunën e Ferizajt 2024-2029 dhe Planit të Veprimit 2024-2027.

I

Miratohet plotësim ndryshimit të Strategjisë për zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë në Komunën e Ferizajt 2024-2029 dhe Planit të Veprimit 2024-2027.

II

Me anë të këti vendimi plotësohet/ndryshohet Strategjia për zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë në Komunën e Ferizajt 2024-2029 dhe Planit të Veprimit 2024-2027. me shtojcën 2 e cila përbanën Integrimin e Agjendave "Rinia, Paqja dhe Siguria (YPS)" dhe "Gratë, Paqja dhe Siguria (ËPS)" në Strategjinë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Ferizajt.
Agjenda Rinia, Paqja dhe Siguria (Youth, Peace and Security - YPS) përfaqëson një nismë globale që ka filluar në vitin 2015 me miratimin e Rezolutës 2250 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Kjo rezolutë shënoi njohjen ndërkombëtare të rolit kyç që të rinjtë kanë në parandalimin e konflikteve, ndërtimin e paqes dhe proceset e rimëkëmbjes pas konflikteve. Kjo qasje u fuqizua më tej nga Rezoluta 2419 (2018) dhe Rezoluta 2535 (2020), të cilat theksuan nevojën për angazhim sistematik dhe institucional të të rinjve në qeverisje, siguri dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Agjenda YPS është konceptualizuar mbi pesë shtylla kryesore.

1. Shtylla e Pjesëmarrjes kërkon përfshirjen aktive të të rinjve në proceset e vendimmarrjes, negocimit të paqes, politikëbërjes dhe jetës shoqërore, duke siguruar që politikat dhe vendimet publike të reflektojnë realisht nevojat dhe zërin e tyre.
2. Shtylla e Mbrojtjes ka për synim garantimin e sigurisë fizike dhe psikologjike të të rinjve, parandalimin e dhunës, diskriminimit dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut, me vëmendje të veçantë ndaj grupeve të cenueshme.
3. Shtylla e Parandalimit fokusohet në adresimin e shkaqeve strukturore të dhunës dhe konfliktit, duke përfshirë promovimin e të drejtave të njeriut, qasjen në arsim cilësor, mundësitë ekonomike dhe programe që ulin rrezikun e radikalizimit.
4. Shtylla e Partneritetit nxit bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet qeverive, organizatave të shoqërisë civile, rrjeteve rinore dhe komuniteteve të ndryshme, si në nivel lokal ashtu edhe në atë ndërkombëtar, për të siguruar qasje të koordinuar dhe efektive.
5. Përfundimisht, Shtylla e Shkëputjes dhe Riintegrimit synon mbështetjen e të rinjve që kanë qenë pjesë e grupeve të dhunshme ose të armatosura, duke u krijuar mundësi për rikthim të sigurt dhe produktiv në shoqëri përmes arsimit, punësimit dhe shërbimeve sociale.

Në mënyrë paralele, Agjenda Gratë, Paqe dhe Siguri (Ëomen, Peace and Security, ËPS), e formalizuar fillimisht me Rezolutën 1325 të vitit 2000, përqendrohet në fuqizimin, mbrojtjen dhe garantimin e rolit aktiv të grave dhe vajzave në kontekstet e konfliktit dhe post-konfliktit. Kjo agjendë adreson në mënyrë të veçantë dhunën seksuale gjatë konflikteve dhe promovon përfshirjen e grave në proceset e paqes, negocime, rindërtim dhe vendimmarrje politike.

Rezolutat e mëvonshme, si 1820, 1888, 1960, 2106 dhe 2122, kanë zgjeruar kuadrin normativ të ËPS duke theksuar përgjegjshmërinë institucionale, parandalimin e shkeljeve të të drejtave të grave dhe ofrimin e mbështetjes së specializuar për viktimat e dhunës. Shtyllat kryesore të ËPS përfshijnë:

1. Pjesëmarrjen e grave në proceset e paqes dhe qeverisjes;
2. Mbrojtjen nga dhuna e ndërlidhur me konfliktin, përfshirë dhunën seksuale;
3. Parandalimin e shkeljeve të të drejtave të grave; si dhe
4. Ndihmën dhe rimëkëmbjen, që siguron qasje në shërbime shëndetësore, psikologjike, juridike dhe në programe socio-ekonomike të rehabilitimit.

III

Pjesë përbërse e këtij vendimi është edhe dokumenti i si shtojcë i lartëcekur.

IV

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit Ferizaj

V

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi I KK-së

Xhavit Zariqi

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.92
Data: 31.07.2026

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 te dates 28.06.2013, si dhe në bazë të kërkesës si MAPL për rishqyrtimin e vendimit me nr 51 i datës 30.04.2026, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.07.2026 miratoi këtë :

Vendim
Për plotësim Ndryshimin e Vendimit 01.Nr.51 i datës 30.04.2026

I

Me këtë vendim plotësohet-ndryshohet neni III i vendimit 01.Nr.51 i datës 30.04.2026, dhe bëhet "Mandati i Komisionit për Ankesa në rastin e dhënieve të pronave në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë është 2 (dy) vite, dhe vepron ndaj të gjitha rasteve të ankesave e jo për secilën pronë komision të veçant për ankesa.

II

Pikat tjera të vendimit nr.01.Nr.51 të datës 30.04.2026 që nuk preken nga ky vendim mbesin në fuqi.

III

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen : Kuvendi dhe Kryetari I Komunës së Ferizajt si dhe Drejtoria e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit e Komunës së Ferizajt.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi I KK-së

Xhavit Zariqi